

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME LUAN KOÇBASHLIUN

Prizren | Data: 19 gusht 2020

Kohëzgjatja: 112 minuta

Të pranishëm:

1. Luan Koçbashliu (I intervistuari)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Renea Begolli (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Erëmirë Krasniqi: Ju lutem filloni edhe një herë prej kujtimeve më të hershme që i keni edhe çka e karakterizon familjen e ju? Prej kur keni jetu në Prizren?

Luan Koçbashliu: Unë jam lind në Prizren dhe rrjedh nga një familje e cila konsiderohet ndër familjet më të vjetra në Prizren, brez pas brezi sipas tregimeve të gjyshit tim. Gjyshi im ka qenë i shkollum, do të thotë ka pasë titullin e Myderizit, sepse në Kajro ka studiu filozofinë islame edhe fetare normal. Edhe kam pasë rast të përfitoj shumë, me thanë shumë jo, por sa kam mujt me përfitu diçka prej gjyshit tem, se ai ka mujt me qenë në kontakt me ato, se ai ka jetu gjatë. Ai ka vdek, gati 105 vjet ka pasë kur ka vdek.

Nga familja e gjerë e babës tem i kam pasë axhallarët. Ata kanë qenë pesë vllazër edhe dy motra. Baba jem ka qenë prej meshkujve ma i vogli edhe shtëpinë e ka pasë këtu afër Shtëpisë së Kulturës, ndoshta e dini, menjëherë mbrapa Kino Lumbardhit aty mu në qendër. Ju tregova kanë qenë pesë vllazën e dy motra. Një kohë kanë jetu në një shtëpi, ka qenë shtëpia e madhe, kanë qenë pasanik, i kanë pasë kushtet e mira. Dhe po du me cek që gjyshi jem ka qenë edhe një kohë mësimdhënës fetar. E ka pasë edhe librarinë e vet mu në qendër të Prizrenit, afër Xhamisë së Sinan Pashës, aty menjëherë {tregon me duar} pak ma nalt.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë literature ka pasë?

Luan Koçbashliu: Literaturë ka pasë librat shkollorë, librat shkollorë. Unë nuk e kam përjetu ato, por më ka tregu djali i axhës tem i cili ka qenë ma i vjetër se unë, se ka arritë edhe ai me punu aty në librari e apostafat librat shkollorë edhe do romane. Mu më kujtohet se nana jem e ndjera ka pasë qef shumë me lexu edhe lypke prej gjyshit tem, sepse ai e dike arabshten perfekt edhe turqishten, atë turqishten e vjetër, normalisht edhe turqishten moderne. Megjithatë, atëherë gjuha qysh me thanë e qytetit ka

qenë, sidomos te myslimanët flitshin turqisht, megjithatë edhe shqiptarët normal kanë... secili prizrenas i flet pak a shumë dy ose tri gjuhë. Tash pak u ndryshu, ma nuk është sikur përpara.

Të vazhdoj, dojke me i lexu edhe gjyshi jem lexojke edhe i përkthejke. Mu më kujtohet, vike te na në ballkon sepse ai kur ka nejt vetëm shkojke te secili djalë ka tre muj e kështu. Kur vike radha te na, nana jem e shfrytzojke rastin me i lexu ato romane të vjetra edhe me i përkthi asaj. Përndryshe, baba jem ka kry gjimnazin, shkollën fillore edhe gjimnazin në Prizren. Por, gjatë shkollimit në gjimnaz, është gjimnazi klasik, ka pasë interesim për stomatologji. Domethonë, për mjekimin e dhomëve dhe në atë kohë në Prizren ishin nja tre, katër dentistë, jo me Shkollë të Lartë, por normalisht dentistët sa për me mjeku dhomtë, me nxerrë dhomtë, me shëru dhomtë. Ai shkojke, së pari ka msu te njëfarë Spi... Spiro Çomiq, ai ka qenë njëfarë qysh me thonë vllah, a diçka...

Pastaj një serb Nikolla Mitroviqi, qysh m'ka tregu baba se unë vet nuk e di, edhe Seb Shkreli po ashtu një dentist. Pastaj, pas Luftës së Dytë Botërore ai e regjistroi fakultetin në Beograd ku e mbaroi fakultetin me sukses dhe u punësu atje menjëherë në Beograd në Poliklinikën Stomatologjike "Magjestik" [Mažestik] e cila edhe ditëve të sotme është një ndër poliklinikat ma të forta, sidomos për protetikën, do të thotë për marimin e protezave. Megjithatë edhe nana jeme ka qenë teknikene e dhomëve. Aty janë njoftu, janë martu, i kanë po tre fëmijtë meshkujt, motrën nuk e kemi pasë.

Erëmirë Krasniqi: Kur u kthyn ata mandej?

Luan Koçbashliu: Prej '50-shit, '52-shit, gati dy, tre vjet kanë punu në Beograd. Pastaj, pak nostalgjia edhe pak mungesa e kuadros deficitare si stomatolog ose mjek të dhomëve. Bëhet thirrja nga ana e Fadil Hoxhës, ka qenë atëherë kryetari edhe Xhavit Nimani edhe ai u detyru të kthehet. Normalisht edhe nostalgjia ndaj vendlindjes i ka mungu edhe ka do të thotë edhe menjëherë është kthi me nanën edhe do të thotë, sa i ka zgjat jeta ka jetu në Prizren, ka bo kontribut të madh. Faktikisht, ka qenë themeluesi i Poliklinikës Stomatologjike Moderne, sidomos në ndërtimin e ambulantës. Ai ka fillu me mjetet e veta ka çelë ambulantën e parë, e cila së pari ambulanta si shtetërore, por me pajisjet e veta. Ka pasë mundësi me pasë një karrigë, atë elektromotoristat që janë për pastrimin e dhomëve. Ma s'pari kanë punu në ish-Fabrikën e Farmakosit.

Fatkeqësisht, kohërave të fundit e kanë rrënu për me ndërtu një objekt modern, megjithatë ajo pjesa ka qenë nën mbrojtjen e monumenteve. Kështu që, Prizreni po degradohet ditë për ditë (buzëqesh). Atje një kohë të shkurtë ka punu, pastaj ka çelë ambulantën këtu ku është medresa e Jakup Beut, tash ku osht' një ndërtesë afër kafiterisë "Korneri", osht' një shtëpi e vjetër që duket tash? A s'e keni vrejt? Nejse, ajo e ka historikun vet, ma s'pari ka qenë medresa e Jakup Beut, ka punu në kuadër të xhamisë së Sinan Pashës, pastaj ka qenë gjatë sundimit të italianëve edhe gjermanëve ka qenë kafe-restorani "Berlin", pastaj UDBA¹ ka qenë e s'di çka, pastaj ambullanta e dhomëve ku ka punu baba jem me stafin

¹ Uprava državne bezbednosti (Administrata e Sigurimit Shtetëroratë).

e vet. Pastaj kur kanë dalë ata në një vend tjetër kanë shku në një shtëpi, po ashtu shtëpi të vjetër në katin e sipërm sepse kushtet ma të mira kanë qenë, e ka pasë hapësirën ma të madhe, osht' njo Ali Dula shtëpia afër Xhamisë së Bajraklisë dhe na kena fillu me jetu në atë katin e sipërm aty.

Erëmirë Krasniqi: E ju domethonë jeni lindë në Beograd dhe jeni rritë në Prizren?

Luan Koçbashliu: Jo, nuk jam lindë në Beograd. Unë jam lindë në Prizren.

Erëmirë Krasniqi: Në Prizren.

Luan Koçbashliu: Unë jam lindë në Prizren.

Erëmirë Krasniqi: E çka janë kujtimet e juja të para?

Luan Koçbashliu: Unë jam lindë drejt me ju thonë në kërthizën e qytetit të vjetër Prizrenit, aty afër Kishës Katolike, nja tridhjetë, katërdhjetë metra. Ishte do të thotë rruga atëherë "Mlladen Ugareviq", sot "Rruga e Bujtinave", janë do hotele, një rrugicë përballë kishës. "Shadërvani" e dini, qaty menjëherë te "Shadërvani", për dy minuta në "Shadërvan", do të thotë jam rritë në "Shadërvan". Kështu, qysh me thanë, jeta ime e vegjëlisë gjithmonë ka figuru edhe ka qenë e koncentrueme në kalanë, nën kalanë, pjesa e Pantelisë, pjesa e Shkulës. Shkollën e kam pasë qaty afër, shkollën dy minutat {shpjegon me duar}, shkolla ish "Mlladen Ugareviq" në atë kohë. Do të thotë, konsiderohet ndër shkollat moderne ma të vjetra, osht' ndërtu në 1836, qashtu diçka edhe këtu Kisha Katolike afër.

Erëmirë Krasniqi: E çfarë jete ka qenë? Ju e përmendët që ka qenë një komunitet shumë i përzimë. Qysh ish jeta në atë kohë?

Luan Koçbashliu: Po jeta ka qenë, për shembull në atë mahallë ku jam lindë unë ka qenë e banume me nacionalitetet dhe fetë tjera. Prizreni karakterizohet si multietnik dhe multifetar qytet. Kemi pasë kojshi shqiptarët katolik, shqiptarët mysliman edhe serbët ortodoks, bile-bile edhe vllahët. Megjithatë, unë jam pak a shumë, jo shumë i bindur, por jam i bindur sepse me një kohë vllahët kanë jetu këtu. Ata dihet që janë shpërngulë nga Shqipëria nëpërmes Maqedonisë. Kështu që, për atë vllahët kanë pasë dy shtresa të vllahëve, cincarët dhe gogat, thojshin cincar dhe goga. Bile, bile lujshin hajgare "*Cincar, goga nema boga*" [srb.: Cincarët dhe gogët nuk kanë zot] sepse nuk e kanë pasë kishën, megjithatë e kanë pasë kishën ju tregoj pak ma vonë. Cincarët kanë qenë tregtarë, e gogat kanë qenë ndërtimtarë. Madje, ato e kanë shfrytëzu Perandoria Osmane gjatë sundimit e kanë shfrytëzu ato për ndërtimin e shtëpive, kanalizimin e krejt ato kanë qenë mjeshtrit për ndërtim.

Erëmirë Krasniqi: Edhe i keni pasë në lagje?

Luan Koçbashliu: Edhe në lagje i kemi pasë ashtu. Kështu që, u përziheshim, flitshim shqipën, turqishtën, serbishtën të përzime. Po them, prej vegjëlisë se nuk ka pasë në atë kohë komplekse do të thotë, ka ekzistuar diku, po situata ka qenë ashtu edhe na dashtë mos dashtë e përqafojshe qato edhe jetojshe normal.

Erëmirë Krasniqi: Diçka tjetër karakteristike prej kësaj periudhe të hershme të jetës?

Luan Koçbashliu: Po tash unë e kam pasë një harmoni në familjen teme, komplet në familjen. Në atë kohë qysh me thonë, ka qenë praktika edhe ndoshta nevoja, se atëherë ka qenë, familjarët kanë qenë pak ma të ngrohtë mes vete, sidomos në Prizren përziheshin me axhallarët, me hallat, me krejt. Më kujtohet kur vike, menxi e pritsha me ardh e shtune edhe e diele me shku me bujtë te gjyshi, mbledheshin krejt axhallarët me fmitë e vet. E ka pasë oborrin e madh, interesant ka qenë, e kemi pasë një mollë të madhe edhe kur e kurdishin atë sofrën ka qenë interesante. Gjyshi jem ka qenë pak serioz edhe i sertë qysh thojnë të na pak (bushëqesh), e ka pasë do principe. Gjithmonë familjari ma i vjetër fillon me qorbën, me kafshatën e bukës. Na si fmitë e prekshim bukën ose me lugë supën me marrë, qorbën me marrë ose nana jeme ose grua e axhës tem, “Jo, mos e prekni!” Gjyshi, “Jo, fëmive ju lejohet, juve s’ju lejohet”(qesh).

Pastaj, qajo molla kur bike sidomos verës, molla e madhe bike e tash kush ma shpejt ka me vrapu atje edhe me marrë ato. Apet më kujtohet gjyshi, po them na ka dashtë shumë se nipa, por i ka pasë do rregullat e veta, për qato ka jetu edhe qaq gjatë. 105 vjet gati m’i përjetu osht’ diçka shumë. Lujshim, për shembull e kemi pasë në oborr ahrit ku u majshin loptë, shkojshin na bijshin punëtorët e tokës na bijshin ato pemët e perimet, kollomoq e misrin dhe qato prodhimet bujqësore edhe na hishim lujshim atje edhe ai gjithmonë dilke. E ka pasë një dhomë si zyren e vet, gjithmonë lexojke, dilke kajherë me na bërtitë. Qajo po më kujtohet. Shoqërinë e kam pasë me fëmijë edhe në shkollë, por mandej përziheshim qoftë katolik, qoftë mysliman, qoftë ortodoks, për ne ka qenë normale atëherë. Do të thotë as prindërit... na e kemi dijtë përkatësinë tonë, por ka qenë edhe toleranca.

Erëmirë Krasniqi: Sa ka qenë e urbanizime Prizreni në atë kohë.

Luan Koçbashliu: Prizreni ka pasë urbanizëm, kur po them e urbanizime sepse Prizreni format urbanistike i ka pasë që nga sundimi i Perandorisë Bizantine, se na i kemi objektet, artefaktet edhe në Muze ekzistojnë edhe janë hala që nuk janë zbulu, por që Prizreni rrjedh ndoshta, te lejmë anash periudhën Parahistorike edhe ato trajtohen si një civilizim, por të Periudhës Romake shumë gurë mbivarrore, motivet të cilat janë gjetur në Prizren ose në afërsi të Prizrenit. Po e zëjmë, sipas të dhënave, sipas burimeve shkrimore Prizreni është urbanizu. Tash nuk i kemi gjetjet brenda qytetit një formë arkitekturore për të çu Prizrenin në Periudhën Romake, në Periudhën Antike po e zojmë. Të Antikitetit të Vonë e kemi, e kemi Kishën e Shën Premtes, Kisha e Lëvishës edhe do objekte të cilat janë gjetur aty edhe në të cilat kemi hasë. Për shembull, qaty “K” ku osht’, qaty kafiteria, ndërtesa e gjatë

afër urës, aty osht’ një objekt i periudhës së Antikitetit të Vonë edhe Bizantin i Hershëm edhe ato janë argumente që Prizreni e ka fillu urbanizmin.

Megjithatë, komplet si është e kam një ide ndoshta edhe nëse më jep shëndeti, unë kam fillu pakëz me punu në rikonsturimin e Prizrenit, eventualisht në Periudhën Romake nuk muj me kap shumë, por Periudhën Bizantine, periudhën qajo e Antikitetit të Vonë, Periudhën e Mesjetës së Hershme, Mesjetë edhe Periudhën Osmane. Për Periudhën Osmane veç e kemi shumë do të thotë edhe fotografitë edhe komplet, kështu që me bo si një hartë, rikonstruktimin e Prizrenit të vjetër. Por, unë kam pasë fat të përjetoj Prizrenin e vjetër.

Ndoshta natyra e jem, ndoshta jo me thonë avanturiste jo në kuptim të keq, por aventura gjithmonë më ka tërhekë, natyra më ka tërhekë sepse edhe gjyshi jem edhe axhallarët e mi kanë qenë adhurues të natyrës. Mu më kujtohet çdo mëngjes gjyshi im çojke, ishte një kojshi edhe kusheri, njëfarë Nexhmedin Tada, familjar i afërt edhe ata janë familje e vjetër qaty ngusht. Bile, çika e axhës tem është martu në atë shtëpi, kojshi, vetëm një mur na ka nda aty, dhe në mëngjes herët dilke dhe shkojke deri te “Pasha Çeshmja” është ndoshta edhe një pjesë e rrafshit përmbi Kalanë e Prizrenit. Deri atje kanë shetitë në mëngjes e mramjes ka ora, sidomos verës edhe kështu kur ka qenë koha e mirë shkojshin deri te Manastiri i Kryeengjujve, deri Kërkbunar është. Në Kërkbunar është një pjesë e bunarit nga ku është shfrytëzu bunari me ujë edhe na e kemi trashëgu, ndoshta unë e kam trashëgu ma shumë se dikush tjetër.

E kam dashtë natyrën, gjithmonë në natyrë jom konë. Bile më kujtohet kur kam marrë vllaun e madh, vllaun e vogël me vete, shkum me mbledh lule për 8 mars për nënën time Jagliga dhe Vjollca edhe e bojshim me një shtagë edhe e bojshim si një buketë të vogël. Erdhëm ka mramje, bile atëherë kemi jetu këtu {tregon me gisht} ku e përmenda afër “Sinan Pashës” edhe baba jem u nervozu, “Ku jeni?” Mu m’lidhi për krevet qaty, vllaut të vogël, “Hajde ti haje bukën”, unë pa bukë edhe qashtu tanë natën kam nejt (buzëqesh). Kurrë s’e harroj ato, sepse u tranun, prej mëngjesit qysh kemi dalë, as buk me hangër as kurgjo ishim nalt në male.

Erëmirë Krasniqi: A u gzu bile për lule nana? (qesh)

Luan Koçbashliu: Po, nana po se po. Megjithatë edhe nanën, nana na ka përkrah, por baba e ka lujt rolin e vet, por edhe nana normalisht.

Erëmirë Krasniqi: Çfare ka qenë nana?

Luan Koçbashliu: Po nanën e kam pasë si çdo nanën me thanë. Nanën e kam pasë me të vërtetë, shumë ka qenë edhe inteligjente, ka lexu edhe na kena msu prej asaj dashurinë për librin. Baba jem ka qenë pak a shumë i ngarkum me punën. Kështu që, jo vetëm që e ka punu ato, por ka qenë ambicioz edhe ka arritë. Bile, ka lyp prej Fadil Hoxhës, se ai i ka furnizu prej Austrisë komplet me pajisjet

stomatologjike, me barnat, me krejt ambulantën, do të thotë repartin stomatologjik prej Austrisë. E ka kërku një ambulantë lëvizëse, i kam edhe fotografitë këtu. Fotografia edhe në një libër ekziston. Ka vizitu fshatrat edhe i ka mjeku fshatarët, dëshmi i kemi fotografitë.

Erëmirë Krasniqi: Nana ka qenë profesioniste?

Luan Koçbashliu: Nana ka qenë teknikene e dhomëve.

Erëmirë Krasniqi: Kur u kthyt në Prizren, a vazhdoi me punu?

Luan Koçbashliu: Po, vazhdoi një kohë, pastaj kur kemi lindë na, kemi fillu pak me u rritë, ai tha, “Ti vetëm ktheu në shpi, rriti fëmijët”. Atëherë ka punu edhe në privat edhe në ambulantë, ka pasë atë privilegj me punu edhe privat tha, “Boll janë këto dhjetë gishtat e mija për me rritë familjen time” (buzëqesh) e ashtu u detyru ajo. Gjithmonë ka pasë nostalgji edhe për atë punë, por ka qenë teknikene e hatashme. Jo që nanën e kam pasë, por hala ka njerëz që e kanë protezën e saj. Bile më kujtohet i ndjeri Refet Kiseri, jo Nehat Kiseri, familja Kiseri po ashtu rruga “Gafurr Kiseri”. Ata janë, a keni ndi për Gafur Kiserin? Në Kaçanik kur e ka ngrit, kur e kanë shpall Kosovën republikë edhe ai ka qenë pjesëmarrës atje. Ai pastaj ka qenë profesor në Fakultetin e Mjeksisë, Stomatologji. Në vitrinën e vet ka pasë çka e ka bo nana jeme në vitrinë si një artifakt muzeal për stomatologji. Deri vonë ka qenë aty, por tash ku osht’ nuk e di.

Erëmirë Krasniqi: Po mendoj, muj ndoshta me ju vet edhe për shkollën e mesme qysh ka qenë?

Luan Koçbashliu: Po shkollën e mesme e kam magjistru në ‘64-shin në gjimnaz edhe gjatë gjimnazit muj me lidh se ka fillu edhe një aktivitet i jem ndryshe pak. Më kujtohet një herë kur kemi dalë një herë në oborr me lujt futboll edhe ka qenë një gjimnasticien i vjetër Ali Qerreti, i cili pastaj ka qenë edhe instruktori edhe profesori jonë për gjimnastikë. Kështu kqyrke qysh e kemi trupin, lëvizjet edhe na zgjedhi. Mu më kujtohet unë kam qenë në klasën time edhe një Venemin Llulla. Ai pastaj ka qenë këngëtar me një grup i Prizrenit “Telstar” i njohur për kohën tonë, ka qenë këngëtar edhe hala knon me klarinetin e vjetër, hala, po po... edhe na kanë zgjedh me shku me ushtru edhe na (buzëqesh) gjimnastikën edhe unë bona aktiv edhe nja gjashtë, shtatë vjet kam qenë intenziv në gjimnastikë. Kemi marrë [pjesë në] gara.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë... a akrobacione?

Luan Koçbashliu: Jo, akrobacione. Qysh me thonë tash, kemi pasë tavolinë suedeze sikur në gjimnastikën që e keni pa në televizor, karrikat {ngrit duart lart} dy të lidhuna me konop, pastaj parter, sallto, sallto mortale, ato çka ka. Do të thotë, kena marrë pjesë edhe konkurentët i kemi pasë, ma konkurentët e Prizrenit kanë qenë Peja, por kemi qenë shumë të fortë sepse i kemi pasë edhe seniore edhe juniore. Na kemi qenë juniorët, e seniorët gjithmonë kanë qenë në vendin e parë në Kosovë. Na

vendin e parë, vendin e dytë, por me hile kejherë se prishtinasit pak me hile (buzëqesh), referët kështu a din edhe gjimnastika e Pejës ka qenë e fortë. Pak a shumë edhe Mitrovica edhe Gjilani ka pasë, Ferizaji jo m'dukët në atë kohë, por e di se kemi marrë pjesë në gara republikane edhe në Jugosllavi.

Erëmirë Krasniqi: Ju çojshin nëpër Jugosllavi?

Luan Koçbashliu: Po, po në kuadër të Jugosllavisë. Ishim në Novi Sad, në Lublanë, në Sarajevë, Beograd. Fitojshim një herë këtu për me shku ma lartë.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenë me dalë prej Kosovës në atë kohë me shku në vendet tjera.

Luan Koçbashliu: Na qaq mirë e kena pasë, pasaportat ishin valide për botën krejt. Pasaporti ma i shtrejt për dikënd ka qenë pasaporti jugosllav. Mund të ju them edhe ndërlidhet me shokët e mi, atëherë para fillimit edhe kur kam fillu me studiu kur vijshim këtu rrijshim para “Therandës”, pijshim kafe, “A po shkojmë në Selanik me pi kafe?” “Po”. Hyp kerrit, shko në Selanik, pi kafe, shko naj disko, të nesërmen kthehesh (buzëqesh). Qashtu e kemi pasë lirinë. Pastaj me shku në Çeko-Sllloveni, Poloni, qeshtu.

Erëmirë Krasniqi: Po mendoj a dallojke, a ka qenë pak shok kulturor me dalë prej Prizrenit me naj qytet ma të madh?

Luan Koçbashliu: Prizreni e ka zënë vendin e parë në aspektin kulturor, megjithatë edhe qytetet tjera. Unë ndoshta, jo s'po foli si lokalist, ndoshta edhe ajo osht', por Prizreni normalisht e ka pasë një kulturë, një edukatë të fortë, se Prizreni njihet edhe Prishtina ka qenë qytet normal, por ma e vogël. Prizreni konsiderohet si qytetet ma të vjetra edhe në Ballkan, e ka pasë urbanizmin e vet, e ka pasë jetën e organizime, ka qenë shumë e pasun, sidomos tregtia edhe artizanatet kanë lulzu në Prizren. Sidomos në mesjetë, duke filluar nga shekullit XIV, XV, veç në shekullin XVI-të kur fillon pak me ra se ndryshimet politike, lëvizjet e lufrat kanë ndiku në zhvillimin e mëtejshëm të Prizrenit.

Megjithatë, ka metë Prizreni ajo hala në thelb sepse shumica nuk e dijnë shpirtin e Prizrenit ku osht', shumica. Ndoshta po them pak ma ndryshe si lokalist, shpirti i Prizrenit është te prizenasi. Prizrenin mundesh me degradu, me devastu do të thotë totalisht, por shpirtin e Prizrenit jo. Shpirti i Prizrenit është çdokund, në çdo pjesë sepse falë pozitës gjeografike dhe kushteve klimatike të cilat i ka pasë. Rasisht nuk janë vendosë këtu stacionet rrugore edhe vendbanimet e periudhave të ndryshme, vend me strategji, për mbrojtje Kalaja është aty dëshmitare. Ma e fortë Kalaja e Prizrenit, se Kalaja e Prizrenit është që nga Periudha e Bronzit.

Kur kemi kur kemi bo gërmimet në 2004 në bashkëpunim me Institutin Arkeologjik këtu të Tiranës për herë të parë u bashkun arkeologët shqiptarë, pastaj kemi fillu së bashku. Megjithatë, ata vijshin te na, e

na te ata jo (qesh). Pak ma ndryshe ka qenë edhe kemi hasë bile te hyrja e Kalasë, menjëherë djathtas aty në shtresën e Periudhës së Bronzit.

Erëmirë Krasniqi: Qysh e dalloni ato?

Luan Koçbashliu: Po shtresat dallohen, dallohen shtresat kulturore, dallon dheu, përbërja e dheut. Kështu që, arkeologjia megjithatë lexohet prej s'poshtit, e na punojmë prej s'naltit. (buzëqesh)

Pjesa e Dytë

Erëmirë Krasniqi: Qysh vendosët ju mas shkollës së mesme masi keni qenë kaq i përfshim në gjimnastikë, qysh vendosët me dalë në arkeologji me studiu?

Luan Koçbashliu: Në arkeologji vendosa kështu, në Kala, pjesa e nën-Kalasë, se harrova me ju thonë se pjesa e nën-Kalasë osht' fillimi i formimit i nën-Kalasë ose përndryshe varosh, ka fillu dikun në fund të shekullit të XII-të, në fillim të shekullit të XIII-të ku ka dëshmi arkitekturore. Megjithatë, edhe në atë pjesë janë gati pesë kisha, qajo pjesa e Kalasë, në Kala jo por përreth Kalasë. Tu lujt atje ndodhi një rast, është një kishë aty "Shën Adhjedhës" i kushtuar nënës së Kralit Marko, keni ndëgju prej historisë për Kralin Marko. Gërmimet i ka bo nifarë Georgi Kovalov me prejardhje ruse me siguri, por arkeolog i cili ka punu në Entin për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës, edhe e kanë detyru, ka bo gërmimet në atë kishë. Edhe unë t'u kalu i pashë shokët, po hi me pa çka po bohet, gërmimet qysh edhe unë u interesova. Dhe për çdo ditë shkojsha me përcjellë ato.

Aty u dashurova në arkeologji edhe megjithatë kam lujt, shumë kena lujt na edhe tash po më vjen marre me thonë, kena lujt edhe futboll mbi një monument (buzëqesh), po ashtu kena lujt futboll në Manastirin e Kryeengjyve, por na s'e kena devastu. Ka qenë terreni i përshtatshëm aty, sepse prizenasit kanë qenë të përqendrum verës gjatë vapës, gjatë nxehtësisë në Central me shku. Centrali e dini ku osht'? Grykën e Lumbardhit me shku ka Prevalla, Manastiri osht' aty, e qajo pjesa pas Manastirit osht' edhe ajo ndërtesa bile, shihet aty para Centralës, është konzervu tash, është bo Muzeu Elektro. I vetmi ndoshta edhe në ish-Jugosllavi atëherë, në Serbi, i vetmi Muze. meritë e Muhamed Shukriuu osht' bo, do të thotë zhvillimi i elektro-ekonomisë. Ajo osht' ndërtu në 1924, do të thotë hidro-elektrana e parë edhe qajo pjesa ishin arra të mdhaja aty në fund, fllad. Qaty bile kcejshim nga penda nalt, laheshim, krejt Prizreni shkojke aty me bukë e me ka krejt. Prizreni do të thotë si një panair.

Kështu që, tu ndejt edhe në Kala. Unë me bo me prej Kalanë e ndej veten gurin e Kalasë. Drejtë me j'u thonë, tash nuk osht' keq me thonë por dikush e kupton keq, mu s'po më pëlqen kjo puna çka osht' bo. Bile unë kam qenë pjesa e hulumtimeve e krejt, osht' bo restaurimi deri diku është mirë, deri diku

tash s'është e thanun me qenë ideale, por tash me prek cimenton unë s'kam qef, gurin me prek. Qatë gurin ish dashtë pak ma natyrale me qenë ajo, por megjithatë nuk e ka hup formën. Kalaja osht' ajo për prezentim mirë edhe tash që pak është adaptu për vizitorët pak e kanë ndryshu pamjen, por turizmi është turizmi. Turizmi din me përfitu, por turizmi edhe shkatrron, ajo është fakt. Në turizmin malor, në turizmin kulturor ka një pjesë që i bon edhe dam. Për shembull, në turizmin malor po të ndërtojsh ti rrugën, ka rrugica, leja njeriut le të hecë nëpër shtigjet, nëpër stazat. Jo tash hiking me bicikletat, rrugën për bicikleta, rrugën për kerre, ti ki dalë në natyrë për me u knaq.

Erëmirë Krasniqi: Edhe mandej?

Luan Koçbashliu: Edhe mandej vendosa me shku në Beograd. Bile, nuk ka qenë se deshta psikologji, e kam dashtë edhe psikologjinë. Shkova me një shok prej ktuhit. Tanë verën nuk shkova në det, vllzërit shkojnë, "Jo, m'u përgatitë për provim pranues". Qashtu hypi në tren. I ndjeri baba ka qenë gjallë atëherë edhe shkova. Kur mbrina aty, ku me flejt? Ishin do punëtorë atëherë në *Gradska čistoća* [srb.: Pastrim i qytetit] që punojshin kosovarët, do të thotë të pastrimit edhe u takum me njonin, qaty hinëm. I Prizrenit edhe kosovar edhe i Prizrenit, "Hajt buni te na. Hiç s'o problem!"

Ato krevetat si në ushtri ishin, nja dy netë me dalë në provim pranues. Ai ka dashtë me regjistru shkenca politike ma së shumti, unë psikologji, jo edhe ai psikologji edhe tani ma boni ftoft ai, ma boni pishman që kurrë s'e harroj në jetën time, por megjithatë nuk jam pishman. "Qysh bre Luan? Na tash po vijmë nga provinca, ata të Beogradit janë ma të dijsëm se na, ma inteligjentë", "Pse more ma inteligjentë po thu qashtu?" Por me atë kompleks, por unë e pata... ndoshta pritojke me hi ai. Edhe unë thashë, "Jo, s'po dalim, s'po dalim". Në mramje trenit, u kthym.

Erëmirë Krasniqi: Nuk aplikut hiç a?

Luan Koçbashliu: Jo, nuk dulem hiç në provim pranues. Ai u regjistru ndërkohë sepse ka pasë, unë kom qenë shëmbullor, ai ka qenë shkëlqyshëm e në fakultet do të thotë me sukses të shkëlqyer ke pasë pa provim pranues m'u pranu. U pranu ai masanej, unë u ktheva, deshta në ndërkohë paralel me studiu edhe arkeologjinë. U ktheva edhe baba jem, "Çka bone Luan?" "Kurgjo, babë", "A dole?" "Jo", "Po ti a je budall? Pse e bone ashtu? Çka do të bojsh tash?" Unë po hypi apet në tren në Beograd. Ora tre ka qenë, gjenerata kineze.

Erëmirë Krasniqi: Çka i bjen ajo?

Luan Koçbashliu: Pse gjenerata kineze? Se deri atëherë dhjetëra, dymbëdhjetë, maksimum 15 vetë regjistroheshin në Arkeologji, a Fakulteti Filozofik atë vit, gjenerata '68-'69, diku pesë mijë studentë vetëm ai fakultet, sepse pa provim pranues. U futën aty studentët që e kanë hup vitin e tash qysh me fitu konviktin, benificionet studentore regjistroheshin në Arkeologji, në Histori, Pedagogji. Unë u

regjistrova në Arkeologji, se deshta në Arkeologji. Ishim atëherë një 600 veta, por pastaj filloi pastrimi kadal-kadale deri sa ka ardhë një 45 vetë.

Erëmirë Krasniqi: Çka mendojshin prind e tu për përzgjedhjen tonde?

Luan Koçbashliu: Nuk kanë qenë kurrë kundër edhe për psikologji. Në përgjithësi jo, “Tash ti po don ato, po ki qef, pse jo?” Vllau jem stomatologjinë e ka studiu, vllau i madh. Ky i vogli ka metë kështu me shkollë të mesme, teknikien i makinerisë. Por edhe ai është adhurues i kulturës edhe kështu vet e bon, e vizaton Prizrenin në piata, por vetëm e ka motivin Prizrenin e Vjetër.

Erëmirë Krasniqi: Pse të veta se të dyjat kanë qenë profesione të pakta edhe psikologjia edhe arkeolog s’ka pasë në Kosovë deri vonë.

Luan Koçbashliu: Deri vonë s’ka pasë dhe mu më tërhek, pastaj çka me studiu? Çka me specializu masandej, nëse e kisha regjistru psikologjinë e industrisë, ajo ka qenë, organizative, psikologjia e punëtorëve. Krejt gjithmonë edhe kur u shoqnojsa, unë nuk i zgjedhsha njerëzit, për mu krejt njerëzit kanë qenë njejt, qoftë pasanik, qoftë i varfun. Bile, gjithmonë i afrojsa ma shumë ata që vijshin nga pjesët rurale se e shoh që pak po tërhiqen. Qyteti si qytet për ata që vijnë nga fshati, mu m’u dhimshin edhe gjithmonë jam edhe qaty pak më interesojke psikologjia a tyne pse po tërhiqen, pse ashtu, pse ashtu. Megjithatë, ajo është një kompleks tjetër.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ke koha gjatë studimeve? Qysh ke jeta në Beograd? Çfarë jete e bojshit? Çka msojshit?

Luan Koçbashliu: Po jeta në fakultet ose...?

Erëmirë Krasniqi: Po edhe në fakultet edhe...

Luan Koçbashliu: Po në fakultet i kemi pasë landët shumë interesante edhe shumë tërheqëse. Për shembull, kemi pasë etnologji, kemi pasë historinë e artit, kemi pasë antropologji fizike çka i mungon disa universiteteve që nuk e kanë pasë. Universiteti i Beogradit e ka pasë edhe gjuhët e vjetra, greqishten e vjetër, latinishtën dhe sllavishten e vjetër. Qaty është përparsia jem e pak a shumë na mundemi, për shembull pak a shumë m’u ballafaqu me tekstet, me përkthi gjatë hulumtimit se janë shumë të nevojshme. Bile unë i preferoj këta kolegët e ri që janë profesora aty, futni se ka nevojë, një shkrim qoftë sllavishten, pa marrë parasysh. Sllavishtja e vjetër i ka shumë germa të greqishtes së vjetër, ani që është serbe me kqyr në atë aspekt. Ajo është dobi për ty.

Shkojshim në ligjerata, pas ligjeratave ka qenë qysh me thonë edhe në Prizren edhe në modë ka qenë do të thotë ka fillu *hippie* moda. Na fillum me u vesh pak ma ndryshe (buzëqesh), pak ma ndryshe normalisht. Si sot edhe atëherë, flokët e gjata. Bile lujke, rahmet i pasë shpirti, baba im kur vijsha unë

prej Beogradit. Një herë kam lëshu pak flokët {bën me dorë sikur e thërret dikë} “Makazet”, gërshantë me m’i pre flokët (buzëqesh). Unë afrohesha, “Jo, jo s’ta preki por shkurto pakëz, jo qaq shumë”. Nuk kanë qenë shumë të gjata, por ne jse edhe ajo koha ka kalu edhe moda ndërrohet normalisht, por pse mos me përcjellë edhe modën kur je aty.

Shkojshim atëherë në matine. E dini çka matine është? Një ndejë me muzik pasdite, jo në mbramje, pasdite. *Igranka* [srb.: ballo] i thojshim, me lojna mramjeve, për shembull prej orës tetë deri në ora dhjetë maksimum, ma shumë jo. Për shembull edhe në Prizren edhe atje ka qenë shtëpia e rinisë *Dom omladine* [srb.: Shtëpia e rinisë] edhe aty vishin orkestrat, vokalet, siluetat e s’di çka në atë kohë që kanë qenë ma të mirët edhe shkojshim. Secili fakultet ka pasë, organizojke do të thotë matinenë ose ndejen e vet, aty shkojshim. Unë, megjithatë kam pasë edhe do kusheri atje në Beograd.

Me preferimin e babës, “Nëse don me studiu edhe me qenë serioz shko në konvikt” edhe unë prej fillimit deri në fund kam qenë në qytetin e studentëve. *Studentski Grad* [srb. qyteti i studentëve] ka qenë në Novi Beograd edhe ajo ka qenë me të vërtetë një jetë pak ma ndryshe, shumë, shumë e mirë. Aty krejt Jugosllavia ka qenë e tubume {kryqëzon gishtat}, qoftë boshnjaktë, qoftë, maqedontë, bile i patëm edhe zezakët. Po edhe zezakët edhe afrikanët, por ata i kanë pasë privilegjet. Më kujtohet një herë në provim, arkeologjia klasike ka qenë te profesori Milutin Garašanin, me fame familje e vjetër edhe ai ka pasë gjyshin Načertanije Garašanin i njoftun për politikën serbe.

Megjithatë, ai ka qenë profesori im, prejardhja e tij s’po na interesohet... Edhe dul s’e di qysh e patë emrin ai, dul, nuk e ka msu mirë edhe ai filloi *bam-bum*, *trapa-trup* {onomatope}, “Po qysh vendin nuk e din? A din ndonjë gjuhë të huaj?” “Po”, “Cilen?” “Gjermanishten”, “Fol gjermanisht”, ai filloi *trapa trup* {onomatope}, “A s’po dike” edhe ka ra (buzëqesh). Do të thotë, ai është një moment që mu m’ka habitë, se ai e dike gjermanishten, frangjishten, anglishten, profesori me famë me renome evropiane, nuk ke mujt me kalu ashtu.

Erëmirë Krasniqi: Po më duket interesant që e përmendët studentat që i keni pasë prej Afrikës, a ka të bëj kjo me politikat e Titos që ka shku me pajtu në këto...?

Luan Koçbashliu: Po osht’ edhe ajo një, por edhe kushtet edhe kushtet. Faktikisht, dikush e ka marrë edhe stipendionin. Shumica prej tyre edhe janë punësu këtu edhe janë martu, ka pasë martesë mes të bardhëve. Do të thotë, në atë kohë nuk ka qenë ngjyra. *Hippie* lëvizja ka pasë ato qëllime liberale me i bashku njerëzit. Tash qiky globalizmi na prishi m’doket (qesh).

Erëmirë Krasniqi: Na ka bo ma racistë (qesh).

Luan Koçbashliu: Na degëzoj pak (qesh). Mos keqkuptoni se ju jeni ajo pjesë e na pleqt ndoshta mendojmë gabimisht, por globalizmi e ka edhe përparësinë edhe ato, por secila lëvizje e ka ato.

Erëmirë Krasniqi: A e përdorshit, po mendoj fakti që ishit në Beograd, se krejt e përmendin që ka qenë shumë metropol, natyrisht ka qenë qyteti kryesor në krejt Jugosllavinë, por ka pasë edhe shumë kulturë të akumulume, ekspozita të mdhaja ka pasë, ngjarje të rëndësishme. A u zhvillojshit ju edhe përmes asaj jete kulturore?

Luan Koçbashliu: Po, qysh jo. Për shembull, qaty ku ka qenë Fakulteti Filozofik, dega e Arkeologjisë, përballë ka qenë Akademia e Shkencave, menjëherë qaty është “Knez Mihailov”. Ajo ka qenë do të thotë rruga ma e preferushme edhe për rininë edhe për turista që ishin me Fakultetin te ndërtesat e vjetra pak a shumë, të ruajtuna. Ajo arkitektura, qysh me thonë postmoderne ka qenë e theksume edhe restorantet ekskluzive aty kanë qenë, Fakulteti, Kalemegdani afër aty për me vizitu Kalemegdanin. Boheshin edhe gërmimet najherë verës, shkojshim vazhdimisht.

Tash kur po e shoh ku është Muzeu Popullor i Beogradit, ku osht’ ajo e famshma për ata Knez Mihajlov në kalë aty me kamë. Ajo pjesë tash është pjesa e gjurmimit, periudha e antikës, e kanë fillu, e kanë gërmu edhe tash fillon hulumtimet hala, e kanë rrethu atë pjesë. Na kena figuru aty, do të thotë kur dilshim në pauzë qaty preferojshim, ishin kafiteritë, naj kafe, dikush naj lang. Atëherë, rrallëherë najkush ka përdorë naj birrë, naj send. Apostafat kur ishim na naj datëlindje merrshim venë ose diçka në dhomat aty të studentëve. Do të thotë, më së shumti përqendroheshim aty, nëpër dhomat e studentëve aty në qendër.

Erëmirë Krasniqi: Shkolla, a ju çojke nëpër sajte arkeologjike, po mendoj në gjurmime. A kishit hulumtime të tilla?

Luan Koçbashliu: Po, detyrë ish, unë apat do të thotë nuk kam qenë i vendosun edhe sot e kësaj dite po më vjen keq që nuk kam qenë, nuk kam pranë me shku në Gjerdap, Lepenski vir² parahistorik. Ajo osht’ periudha mezolitike, do të thotë 9000 vjet para erës tonë. Osht’ një vendbanim i veçantë në Evropë, a tash është fantazi. Çfarë prezentimi e kanë bo, në botë nuk e ka asi prezentimi. Me të vërtetë ekstra profesional prezentimi në atë vendbanim edhe u bona pishman që nuk shkova. Bile babës i thashë, “Po pse nuk ke shku?” “Çka po di!” Thashë, “Hajde në Prizren me shoqëri” edhe nuk shkova. Por, megjithatë për fat si student i vitit të parë me Edin [Shukriu] kemi marrë pjesë në Kala të Prizrenit të Mesjetës.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenë ajo? A mundesh me më tregu qysh u inicë, prej kujt?

Luan Koçbashliu: Inicimi ka qenë kështu. Kur është formu Muzeu Arkeologjik, do të thotë u hap dega edhe për arkeologji.

² Lepenski Vir, e vendosur në Serbi, është një site i rëndësishëm arkeologjik i kulturës Mesolitike të Portave të Hekurta të Ballkanit. Të dhënat më të fundit të radiokarbonit dhe AMS sugjerojnë që kronologjia e Lepenski Vir është e ngjeshur midis 9500 / 7200–6000 para Krishtit.

Erëmirë Krasniqi: Në cilin vend?

Luan Koçbashliu: Do të thotë, në Sahat Kullë kur osht' Muzeu. E tash, Enti për Mbrojtje atëherë kur thashë edhe me kuadro ka qenë ma e pasun. Do të thotë, nëse krahasohemi me Entin e Kosovës, ata normalisht ma shumë kanë qenë, por Prizreni i ka zënë vendet e para m'duket. Kështu i ka pasë dy arkeologë, fillova prej arkeologëve, historian i artit, orientalist, etnolog, arkitekt, teknikient të arkitekturës dhe ndërtimtarisë, piktorë konservatorë që s'ka pasë kërkush në Kosovë, vetëm njëfarë Afrimi, ai hala osht' në Pejë. Vetëm ai një kohë të shkurt ka punu në Entin për Mbrojtjen e Monumenteve edhe pastaj shkoi në privat se historinë e artit e ka kry ai edhe piktor.

Masanej ku shkoi, hala jeton në Prishtinë edhe Thiaz Drançolli është një gjeneratë para meje, historinë e artit, por jo piktor konservator, vetëm Prizreni ka pasë. Çka osht' kuriozitet, se Muhamedi qaq ka dasht' me përparu stafi i tij. Kështu që, krejt ato piktorët konservatorë ka qenë Ferihaja, Feriha Rada, ajo tash në Angli osht', i ndjeri Vefa Hapçiu, ai skulptor, Rexhep Vërmica jeton në Suedi, e ka atelenë e vet, Fevzi Tüfekçi osht' profesor në Universitetin e Stambollit, atje e ka kry edhe Akademinë e Artit, Mlladen Nedelkoviqi. Ata pesë veta, po pesë ishin.

Secili ka specializu qoftë në Muzeun e Beogradit, qoftë në Poglavë, qoftë bile ajo Feriha ka shku në Francë një vjet e gjys. Madje biologu, se biologun e kemi pasë, ai një vjet e gjysë ka specializu në Pragë në Çeko-Sllovaki. Kështu që, shumë rëndësi i ka dhënë kuadros, jo sikur sot që po shoh. Më falni që po them, por po du me ndërlidh qysh ka qenë përpara, qysh osht' tash. Po punësojnë njerëz që nuk janë adekuat për atë punë. Po hijjnë në punë juristët ose ekonomistët që nuk kanë lidhje me trashëgimi ose me diçka tjetër. Qajo osht' fati i jonë tash, e ardhmja e jonë.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ke qajo përvojë tash me qenë i rrethumë me krejt këta profesionistë? Keni qenë viti i parë në Fakultet, keni qenë me krejt këta profesionistë në Kala.

Luan Koçbashliu: Po, po aty e kemi msu. Do të thotë, unë vizualisht e kam pa qysh gërmohet. Pastaj profesori edhe studentët pak ma me përvojë, vetëm Edi edhe unë pak ma nuk kemi pasë përvojë të gërmimeve, viti i parë. Se me pasë përvojë, kishte edhe të pagum, se kemi punu si vullnetarë. U dashtë me pasë ma s'pakti një arkeologji, një provim të arkeologjisë. Në arkeologji kemi pasë parahistori e cila ndahet me periudhat e veta, Arkeologjinë Orientale, Arkeologjinë Klasike dhe Arkeologjinë Parahistorike edhe Arkeologjinë e Mesjetës. Kështu, këtu ka qenë Mesjeta. Megjithatë, na kemi hi pastaj edhe ma thellë e kemi zbulu [periudhën] edhe të Antikitit të Vonë edhe Bizantit edhe krejt ato sene i kemi bo ma sistematike.

Erëmirë Krasniqi: Domethonë, keni fillu me Mesjetë a?

Luan Koçbashliu: Po me Mesjetë, peirudhën osmane, periudha osmane ka qenë pjesa e fundit, sepse shumë ndryshime janë bo. Madje, në Kalanë e Prizrenit ka gjashtë faza të ndërtimit dhe mbindërtite

në periudhën osmane, të sundimit të Perandorisë Osmane. Pastaj, shtresa tjetër është Mesjeta gjatë sundimit të Nemanjidëve³. Aty pak a shumë, ata nuk kanë sundu shumë, një kohë të shkurtë. Do të thotë, si mbretërit, pastaj është sundimi tjetër osht' diçka tjetër. Parahistori e kemi periudhën e Bizantine. Bjen kur kanë qenë bullgarët, por bullgarët kanë qenë dëmtuesit ma të mëdhenj të trashëgimisë, ata kanë shkatrru monumentet historike, bile edhe arkivat i kanë shkatrru kur kanë sundu. Dy herë kanë sundu në Prizren, një herë në shekullin X, një herë në shekullin XI edhe këta pleqtë thojshin, "Aman vetëm bullgarët mos t'na vijnë këtu", me të vërtetë është e vërtetë ajo... Edhe pastaj shkon bizantine, antikiteti i vonë edhe periudha e bronzit, pak a shumë me gjetjet shumë, fragmente amorfe s'na tregojnë kurgjo, por e dijmë që janë asete të asaj periudhe.

Erëmirë Krasniqi: A mësut shumë gjatë asaj periudhe?

Luan Koçbashliu: Mësum gjatë asaj vere, shumë mësum. Pastaj, fillum gërmimet në Romaj, tumat ilire, në Vermicë osht' Nikropoli i madh i mesjetës së hershme. Aty në kuadër të atij projekti që thash që e ka organizu Muhamed Shukriu. Projekti ka qenë rreth 660 milionë dinarë, por aty ka qenë e parapame edhe pagesa e dëmtimeve të tokës, sepse ato hijnë nën ujë i kemi bo hulumtimet. Survejimet ma s'pari i kemi bo me Edin, komplet në luginën edhe në anën e djathtë edhe në anën e majtë.

Erëmirë Krasniqi: Qito e keni bo si studentë a?

Luan Koçbashliu: Po, po, ato gjatë studimit, para se me u punësu.

Erëmirë Krasniqi: A po na tregon për këto, qysh keni vendosë me bo këtë survejim.

Luan Koçbashliu: Po ajo ka qenë në projekt. Jane rreziku lokalitetet edhe na u dashtë me i evidentu ato lokalitete se... të mundet me bo projekti për me i shpëtu ato, se na nuk e dijsim deri ku do të vjen uji, deri ku do të mbulohet me ujë, por pak a shumë lokaliteti i Vërmicës. Aty e kemi edhe një Kishë Paleo-Kristiane aty e zbulum edhe rreth 460 e kusur varreza. Edhe osht' interesant me thonë se, përveç ato i kemi bo edhe hulumtimet antropologjike.

Do të thotë, fal Muhamed Shukriu, fal drejtorit e ka angazhu një profesor të njohur János Nemeskéri, është hungarez i cili ka ardh me asistentin e vet Laslo, emrin Laslo, mbiemrin nuk e kujtoj. Unë kam pasë një privilegj me marrë pjesë nja deri gjashtë muj ditë, gati gjashtë muj ditë me ato me punu në hulumtimet antropologjike edhe shumë të dobishme për mu edhe për kolegun tjetër Vefanë. Pastaj ka kry për riparimin e aseteve arkeologjike, riparimin do të thotë edhe konservimin e materialit arkeologjik në Muzeun e Beogradit.

³ Nemanjiqët ishin familje mbretërore dhe sundimtarë të Serbisë mesjetare. Ishte dinasti e madhe serbe. Sundimtari i parë i dinastisë ishte zhupani i madh Stefan Nemanja i cili sundoi nga 1166-1196, më vonë ai u bë murg.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë metodologji i përdorshitet për me dokumentu?

Luan Koçbashliu: Qysh po mendon?

Erëmirë Krasniqi: A i fotografojshitet a...?

Luan Koçbashliu: Fotografimi, matjet, krejt ato do të thotë, atë metodologji edhe aty. Bile interesohesha, profesorit i thashë, “Profesor a mundeni ju *invivo* me matë kokën tem çfarë tipari i përket, i parkas unë?” Tha “Pse jo?” Edhe djalë e madh e pata me vete atëherë, t’u kalu erdhi me më vizitu. Na mati tha, “Ju jeni të tipit mediteran”, se kështu kafkat ilire {prek pjesën e pasme të kokës} janë apostafat specifike, ballin e kanë kështu {prek ballin}. Madje, pas atyne, do të ju vjen rasti të ju tregoj për antropologët e Shqipërisë që kanë marrë pjesë këtu. Edhe me ata qeshtu gati gjashtë muj qitu në Hamam, ku osht’ Hamami aty kanë qenë vendosë edhe rezultatet mbetet të na dërgoi ai.

Ndërkohë situata u ndryshu, fillojnë ato trazirat e ‘78-shit, ‘79-shit, ‘80-shit, sidomos në kohën ma të keqe kanë ardh edhe antropologët e Shqipërisë këtu. Pritëm me na ardh rezultatet, rezultat nuk erdhen, diku u stopun në Beograd se ata thojshin që janë varrezat e sllavëve, që janë varrezat e sllovenëve. Megjithatë, sllovenët kanë jetu këtu, kanë ardh në shekullin e VII-të, por nuk kanë qenë të tyre, se unë kam folë me profesorin.

[Prerje në montazhë]

Sipas hulumtimeve të tij nuk janë. Kjo osht’... ka ndonjë të përzier, por megjithatë janë vendas ilir, do të thotë arbërit, se atëherë emri i ndërrohet prej ilir në arbërit. Kështu mbeti edhe deri në ditët e sotme na veç nuk kemi mujt me gjetë asi. Në atë kohë e shfrytëzoi rastin Muhamedi, e shfrytëzoi rastin e çoi në Ulqin te vorri i Ymer Prizrenit, e kanë nxerr vorrin e Ymer Prizrenit, e prunën këtu në Prizren. Ky e ka hulumtu ato komplet edhe sipas atij ky Fevzi Tüfekçi, ai ka qenë shumë konstruktiv piktor, e ka bo portretin sipas ashtit, se tash me këto paisjet moderne pe bojnë rikonstruktimin e njeriut parahistorik, aq kanë shku. Për sa ka mujt ai edhe sipas fotografisë edhe sipas kafkës e kanë bo foton origjinale të tij edhe masandej...

Erëmirë Krasniqi: Vetëm ndoshta te përmbysim fakultetin. Kur u kthyt? Edhe a ke najfarë difference e madhe? Qysh ke jeta? Qysh u zhvillu mas diplomimit?

Luan Koçbashliu: Mas diplomimit u martova. Heret jam martu drejtë me ju thanë, 24 vjeçar. U punësova menjëherë qaty edhe apet po them të punojsh edhe në Muze pa marrë parasysh, se kur fillova me punu... gjatë ‘75-shit është hapë Muzeu, vijshin vizitorët gati nga e tërë bota. Për mu ka qenë interesant të jesh në kontakt me shumë njerëz edhe me tyllifarë njerëz. Osht’ një përvojë e madhe, pyetje provokuese sa t’dush, por unë gjithmonë në jetën time e kam një limit, një limesë, një kufi sa

më lejon dijenia me folë, as një çik s'du me dalë prej gojës teme, qasi tipi jam, prej gojës tem diçka çka nuk jam i sigurtë nuk muj me folë.

Bile më kujtohet një nuk ka qenë edhe provokim, ka qenë bashkiaku i Zagrebit në Kroaci një delegacion, erdhen këtu edhe patjetër vijshin, si të vizitojnë Kosovën pa marrë parasysh. Bile, ka qenë atëherë [Robert] McNamara, drejtori gjeneral i Bankës Botërore, Ambasadorët e shumë e shumë njëerëz, kinezët a japonezët, krejt bota gati qaty në Muze. Osht' libri e kam rujt, s'e di tash a osht' e kam rujt, s'e di tash a e rujt a s'e rujn nuk e di, libri i përshtypjeve. Ai është një histori, ai është një dokument pa marrë parasysh ai e ka shpreh mendimin e vet. Nuk e kanë vazhdu me ato e duhet me vazhdu. Tash nejse ka mjete të tjera edhe gojore. Dul ai, dulem përjashtë edhe unë i tregova, i skjarova komplet historikun e Muzeut, objektet krejt çka. Kur dulem në oborr e kemi çesmen, e kemi marrë prej rrugës aty, njëfarë "Çeshmja e Esmë Hanmit", do të thotë është një njeri që e ka ndërtu çesmen kushtuar një femrës të cilën e ka dashtë shumë edhe shkojke shpeshërë me pa ato kur shkojke me marrë ujë dhe u dashuru me ato, por ajo vdiq herët si vajzë.

E në atë çeshme ai tha, "Po boj une, me pi ujin" edhe më tregon kështu, ma s'pari po të tregoj serbisht me pasë kuptimin, kroatisht tha "*Da li je ovaj muzej dostigao nulti stupanj?*" [kro.: A ka arritur ky muze në shkallën zero?]. *Hop* [onomatope] unë njëherë u ndërpreva. Do të thotë, në shkallën e fundit, në shkallën zero, do të thotë s'ka ma zhvillim, nuk ka. Por tash nëse e shohim objektin, perimetrin, objektin sa hapësirën e ka, ai faktikisht nuk mundet me u zhvillu. Mundet ndoshta me zhvillu në rast se realizohet projekti i djalit të axhës tem të ndjerit, i cili ka dashtë me bashku Kishën e Shën Premtes me Muzeun, se ka indikacione që ka qenë një banjo romake aty. Ka indikacione, por ajo mbetet për hulumtuesit kur të vijnë të tjerët (buzëqesh) me bo një kompleks me lapidariumin, me i qit gurët mbivarore, plastikate e gurit, krejt ato çka shkon nëpër oborret e Muzeut. Qashtu e kena planifiku, por ai vdiq masandej edhe nuk u realizu projekti.

Edhe i thashë, "Nuk kisha thanë", përgjigja jem ka qenë momentale se tu e mendu për çka mendon, por masandej e zbuta njëherë deri sa deshta me ardhë me një konkludim çka me thanë. Thashë, "Po tash gërmimet vazhdojnë dhe ekspozita ndërrohet, zhvillohet dhe ndërrohet në mënyrë permanente, varet prej zhvillimeve në arkeologji qysh. E dyta, sa i përket hapësirës, ndoshta bohet dikur, zgjerohet kjo edhe qaq". Nuk osht' edhe ajo *nulti stepen* [srb.: shkalla zero] a mundet me thonë edhe osht', varet qysh bohet masandej, ndërrohet situata sikur qysh u ndrru. A shkon tash me vizitu dikush Muzeun? Rrallë kush shkon, pak osht' vend me anashkalime, por megjithatë tash i ka ato shtigjet që tregojnë, shkojnë vizitorët.

Erëmirë Krasniqi: E qysh ka qenë në të '70-tat me pasë Muze me hapësirë ekspozuese, se në Prishtinë s'ka qenë, nuk e kemi pase idenë e ekspozitës.

Luan Koçbashliu: Po idenë e ekspozitës unë para se me ardhë veç e kanë bo. Do të thotë, Muhamedi ka dashtë se Muhamedi... muzeu i parë ka qenë Muzeu i Lidhjes së Prizrenit ku punon vajza jem, ajo

është etnologue, është përgjegjëse e sektorit etnografik aty. Ai e ka zhvillu. Unë të thashë që e ka pasë vizionin Muhamedi shumë. Muzeun e Dorëshkrimeve i cili ka qenë deri viteve '76, pestë, a gjashtë, a shtatë brenda në vitrinat me dorëshkrimet arabe të vendasëve.

Erëmirë Krasniqi: Të vendasëve?

Luan Koçbashliu: Po, të vendasëve këtu të regjionit të Prizrenit. Bile i lypke edhe librat e gjyshit tim, por atëherë baba jem ka qenë smutë edhe s'ja kanë dhanë e s'di çka u bo meten ato libra. Tash ato libra na i posedojmë, tonat janë. Masanej, Lidhja e Prizrenit, Muzeu i Dorëshkrimeve, Muzeu i Revolucionit ku osht' Ina e vogël [pompë e benzinit], masanej Muzeu Arkeologjik. I pari në Kosovë ka qenë audio-voksi në Kishën e Shën Premtes në dy gjuhë, në gjuhën franceze, në gjuhën serbe edhe një gjuhë ka qenë audio-voks, e lëshon e ti shetitësh, zoni tregon kush osht'. Qaq kena qenë përpara, bile instituti jonë ka pasë pesë, Enti për Mbrojtjen, pesë shtëpi kulturore, më fal, pesë kamp-shtëpiza për terren, traktorin, kamionin edhe dy kerre. Një kerr luksoz për me dalë për shkak të punëve edhe një kerr për qytetin, për terren e kështu. Nga muzetë qato janë muzetë.

Erëmirë Krasniqi: Nuk keni pasë veç ekipe hulumtuse, por keni pasë edhe hapësirë ekspozuese për to, e keni pasë njëfarë ideje edhe turistike.

Luan Koçbashliu: Po, gjithmonë ideja, gjithmonë me bo ekspozutën para se m'u hap Muzeu Arkeologjik, ekspozita e shfrytëzoshim hapësirat e Hamamit të Mehmet Pashës.

Erëmirë Krasniqi: Aty shkojshin i shpalosshit gjetjet?

Luan Koçbashliu: Po, po edhe aty kemi hulumtu, kemi dashtë me siguru mos ka naj banjo ma e vjetër, nuk e kemi hasë të temelet ma të vjetra, u bo restaurimi, UNESCO i ka financu pakëz. Tash çka do të bojnë me ato? Po mendojnë ato me bo, po mendojnë ato, s'e di çka me bo, osht' një tollovi në atë aspekt edhe kur deshta me thonë për antopologët e Shqipërisë edhe ata kanë qenë.

Erëmirë Krasniqi: Qato deshta me ju vetë, kur ka pasë bashkëpunime Kosovë-Shqipëri gjatë viteve të '70-ta, ka pasë njëfarë shkëmbimi të ekspertëve prej të dy anëve. A ka pasë edhe...?

Luan Koçbashliu: Po ka pasë, por rrallë kush ka pasë prej neve arkeologëve. Vetëm më kujtohet Exhlale Dobruna, ajo edhe profesoreshë në Fakultet ka qenë, ka punu në Institutin Albanologjik si arkeologe dhe...

Erëmirë Krasniqi: A kanë ardhë edhe ata këtu të Shqipërisë?

Luan Koçbashliu: Të Shqipërisë kanë ardhë disa herë viteve të '70-ta, Muzafer Kurkuti, Meriton Ceka janë arkeologë me famë shqipëtarë edhe s'e di kush tjetër. Unë nuk kam qenë prezent me ata atje, ka

qenë Kemal Luci, kolegu jem ato e njifni me siguri. Ato e kam nga kolegët ma të afërm, se kemi punu bashkë në shumë hulumtime në Brezovicë e ka qenë projekti jem, pastaj në Malishevë, kultura e Parkomanit qatë në Kosovë që u zbulu.

Pjesa e Tretë

Erëmirë Krasniqi: Tregoni për këtë ofertën turistike që ka të bëj me trashëgimi?

Luan Koçbashliu: Po çka ka të bëj? Kemi pasë për secilin objekt veçantë prospekt, ato që e ka bo do të thotë Enti për Mbrojtjen e Monumenteve, faktikisht pastaj edhe për Muze i njejti gja. Ndërkohë, idea e drejtorit ka qenë të organizohet një ekspozitë për historikun edhe çka ofron Prizreni si një qytet-muze, qytet-përmendore qysh e kanë thanë edhe serbët.

[prerje në montazhë]

Erëmirë Krasniqi: Domethonë, ju u angazhut?

Luan Koçbashliu: Po, u angazhum komplet, do të thotë secili në profesionin e vet me përgatitë materialin. Na e kemi pasë lehtë sepse e kemi pasë ekspozitë, vetëm ish dashtë me përmbledhë. Do të thotë, eksponatet janë ato ma treguese, ato ma të mira edhe pastaj etnologë kanë pasë detyrë m'u veshmbathje, veshjet se Prizreni e ka edhe veshjet qytetare rrethinën e Prizrenit fshatarët që osht' edhe ato e bojshin në një formë, qysh me thonë tash në formë të televizorit, fotografia si në negativ kolor, brenda ndriçimi edhe komplet një hapësirë me ato veshjet e prezenteve, do të thotë në koloritet fantazi diçka. I kemi pasë kartolinat e veta me veshjet e Hasit të burrave dhe grave e prej dokumentacionit, dorëshkrimet arbashit, turqisht, pastaj do fotografi të vjetra pak a shumë, e qashtu. E kemi mbledh komplet, do të thotë e kemi bo. Pastaj erdh prej komitetit një urdhër që nuk mundemi me bo, me realizu atë ekspozitë.

Ajo ka qenë një herë në Japoni me shku, pastaj edhe në Evropë. Unë sa e di ka qenë itinerari kështu Prizren-Beograd-Stamboll-Moskë-Tokio-Kjoto-Nagasaki *[prerje në montazh]* edhe në Hong-Kong edhe kthimi në Prizren. Kështu ka qenë itinerari, nuk u realizu edhe mandej kështu.

Erëmirë Krasniqi: Në cilin vit ka qenë kjo?

Luan Koçbashliu: Në '75-shin, '76-tën, sidomos unë kur jam kthy prej ushtrisë atëherë u bo, se unë kur kam qenë i punësum erdhi në fund, si thojnë mohikani i fundit, 36, 37 vjeçar kam shku në ushtri. Ka qenë i fundit patjetër me shku.

Erëmirë Krasniqi: Që jeni dashtë me tregu veten. Qysh ka qenë me shku në ushtri atëherë?

Luan Koçbashliu: Po mirë bre, me thonë mirë kam kalu edhe aty. Kam pasë fat drejtë me thonë, apet fat kam pasë sepse kam qenë në njësi inxhinjeri pionere, ato me minat montimin, demontimin. Bile kur më kanë thirrë për kontrollë këtu për me çu edhe aty i zgjedhshin në cilën njësi kemi me shku, “Ti” po thotë, “*Pionirska inžinjeria*” [srb.: inxhinjeri pionere], do të thotë inxhinjeria, punëtoria për me renovu urat edhe krejt ato çka ka të bëjë me minat. “Po pse çka kam unë tash me minat?” “Po ti je arkeolog, ju po puponi me mistri”. Thashë, “Qy, çfarë logjike!” (buzëqesh) E kam refuzu disa herë shkollën rezervë oficere, e disha që obligime janë pastaj, thirrin në ushtrimet e s’di çka, janë peripeti e unë shkova në Ohër pastaj, e zgjedha (buzëqesh).

E në Ohër e bona atëherë e pata edhe djalin edhe nusen edhe disa herë kanë ardhë atje në vizitë edhe apet pata fat inxhinjeri. Menjëherë pasi që e dhamë betimin, mu më dhanë kabinet të inxhinjerisë dhe aty ka qenë ligjerata e programume me kamerë edhe me tastierë, ashtu. Unë vetëm me papuqe tanë kohën. Kur pastrojshin e angazhojsha veten t’mitë, pastrimi një herë në muj total, me parket e me ka krejt. Unë vetëm {thërret me gisht nga vetja} shqiptarët i nxerrsha, “Hajdeni” edhe u ankojshin. (buzëqesh) E kanë pasë Ivica Gashparoviq, kroat por më duket që ka qenë pak në gjakun e arbëreshve ai. Mesiguri, se ka pasë simpati e ma i ri se unë. Nëntoger ka qenë ai.

Erëmirë Krasniqi: Patët fat edhe në ushtri kështu.

Luan Koçbashliu: Qashtu, qashtu edhe në Beograd kemi kujtime, si Beograd normalisht. Megjithatë, unë Beogradin nuk e njofta prej, se i kemi pasë kushëritë atje në Beograd e disha Beogradin mirë, por jeta ndryshe.

Erëmirë Krasniqi: S’kishit pengesa në gjuhë?

Luan Koçbashliu: Jo, me gjuhë kurrëfarë pengese, kurrëfarë pengese.

Erëmirë Krasniqi: E mandej këtu kur jeni kthy keni punu shumë edhe në atë, të ju kthehemi edhe atyne projekteve që kanë të bëjnë edhe me trashëgiminë edhe ofertat turistike. Çka u mendojshit me komunikimi sa i përket vlerave të Prizrenit në atë ofertë. A u mendojshit me tregu që kanë ma shumë lashtësi apo me folë ma shumë për urbanizimin, po po ashtu e ka njëfarë...

Luan Koçbashliu: Po mendoj çka kisha mujt une?

Erëmirë Krasniqi: Jo, ju, por si institucion çka u mendojshit me qit përpara si ma e rëndësishmja?

Luan Koçbashliu: Po, po kështu tash normalisht sipas kushteve edhe na veprojmë sipas kushteve. Por, prezentimi edhe promovimi nuk ka qenë ku me ditë. Ka qenë në nivel sepse na detyroheshim për shembull si guida me qenë. Historiani i artit shkojke në kishat me tregu, orientalisti shkojke nëpër xhamitë, megjithatë aty ka pjesë edhe historiani i artit se ato pikturat lidhen me historinë e artit. Orientalisti me dorëshkrime, kurse arkitekti për arkitekturë, por për arkitekturë ka mujt me fol edhe historiani i artit se ata pak a shumë e njohin arkitekturën se qysh thirret e çka osht', tek osht'.

Ne normalisht në arkeologji vet, etnologjia vet, secili nga këndvështrimi i vet. Por, vike momenti për shembull kur s'kena pasë ku me ditë çfarë projekte me punu. Po du me cek, kur e kemi marrë evidentimin e monumenteve folklorike, do të thotë shtëpitë folklorike ma s'pari fillim nga Varoshi, nga Podkalaja. Më i pari ka qenë Enti i Prizrenit i cili ka përdorë formularet e UNESCO-s, do të thotë kanë qenë plot. Çka osht' diçka që deri tash që hala nuk e kanë o këta tonët, nuk e kanë gjetë arsye ose e kanë anashkalu, diçka ka ndodh se hala nuk e kanë kategorizimin e monumenteve, por kategorizimin e monumenteve brenda një njësie.

Për shembull, arkitektura, monumentet kishat, xhamijat, secila i ka kategoritë e veta e sipas asaj bohet kategoria e parë, e dytë, tretë, katërt, sa kategori i ka. Na ato e kemi bo. Na ato e kemi punu shtëpi për shtëpi, ku s'kam pasë për shembull unë punë me arkeologjinë, me gërmimet se në Muze dy veta ishin. Kaniherë për vizitorët kemi përgatitë edhe rojtarët pak a shumë me tregu sendet elementare, jo qaq shumë. Detyroheshim me shku, për shembull në krejt shtëpitë brenda në nën-Kala, pod-Kala, Panteria, në krejt ato lagjet e vjetra kemi hi brenda, kemi evidentu historikun me fotografitë, me fotot çka kanë prej antikitetit, komplet dy faqe me rubrikat e veta.

Do të thotë, diçka puro, do të thotë plot profesionale. Atëherë qashtu kemi punu edhe tash nuk them jo. Tash kanë njerëzit dëshirë me punu, ka njerëz, po çka me bo? Alamet u formu Instituti për Arkeologji, por ideja ka ra në Kala të Korishës kur ka qenë Brajshori ministër i kulturës i pari, kur është formu Ministria e Kulturës, ai ka qenë ministër i parë. Qaty ra idea me formu Institutin Arkeologjik edhe pas një viti u formu edhe u bo Jahja Drançolli drejtori i parë i Institutit Arkeologjik, ai historian pa marrë parasysh çka osht' tek osht'.

Erëmirë Krasniqi: Këto praktika a nuk mrrijet me i përcjellë në gjeneratat tjera, a çka ndodhi?

Luan Koçbashliu: Po, ndërkohë e flejti, pushoi ajo studentët në arkeologjinë edhe historinë e artit.

Erëmirë Krasniqi: Çka ndodhi pra në '89-tën për profesionin e ju? Kur u shpërbë Jugosllavia, çka ndodhi për profesionin e ju?

Luan Koçbashliu: Kur u shpërbë Jugosllavia atëherë hinem në Serbi. E në Serbi dihet projektet kush i ka bo, i kanë bo edhe Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit, por gjithmonë ka qenë e koncentrueme, tash s'kam çka me rrejt, aty, aty do gërmime, do të thotë të shpëtimit i bojshim, por

gjithmonë koncentroheshim periudha e Mesjetës, periudha e sundimit ma së shumti. Duhet me qenë korrekt, kanë qenë edhe gjërmimet tjera me karakter tjetër. Për shembull, pas ramjes së Ranković-it u punu Romaja, u punu Xhonaj, u punu Vërmica, u punu Reshtani, s'di cilat lokalitete tjera...

Pastaj pas luftës na e kemi fillu tjetër, por gjatë sundimit sa e di unë. Pastaj këtu para Hisarit është një fshat edhe aty. Megjithatë, ato çka i interesohet ka qenë për periudhën e vet. Do arkeologë që kanë punu aty, ata janë mundu të gjërmohet vetëm ato çka i gjërmojnë ata, po e zojmë Parahistorinë, periudhën e Bronzit, ose e Hekurit ata e punojshin, a në përgjithësi kishat. Që për shembull, unë kom gjërmu në oborrin e Kishës Qëndrorë këtu, kjo e Shën Spasit {bën me gisht prapa} kam gjërmu, përballë aty ku është "K" është Kisha e Shën Pjetrit, aty kam gjërmu. Po detyra, detyra jem masi që thanë edhe me Mesjetën i kam bo gjërmimet, kam dhënë raportet e mia edhe krejt qashtu.

Por, gjithmonë mundoheshim të jemi korrekt, të jesh korrekt pa marrë parasysh, sepse mu më kujtohet në '92-shin fillun gjërmimet në Manastirin e Kryeengjujve. Këtu ka qenë një profesor Mihajlo Milinković ekspert ndër ma të njohurit për Evropën jug-lindore për periudhën e Antikitetit të vonë, Mesjetës së hershme. Une pata nder me punu me to, po thom edhe nga korrektësia tu e gjërmu rastësisht, tash tu e gjërmu nuk osht' rastësisht, erdhëm me një shtresë. Mu po më duket parahistoria edhe atij po i duket parahistoria. Unë po e kqyri ato, ai po më kqyr mu, po thotë, "Jel se za isto smejemo", kishe a po keshemi për të njejten. Thashë, "Po më duket prej keshjes tonde po më dukesh që po", por çka na bojnë kta tash.

Brenda Kishës gjendëm shtëpi të periudhës së Hekurit, dysHEME. Si sot më kujtohet dy metra, dy metra e tre centimetra thellësia e pjesës së poshtme, do të thotë ku vjen hapësira e Kishës. Tash ose na lavdërojnë ose na qesin përjashtë. Por, ka qenë korrekt ai edhe kur ka publiku, ka botu "Glasnik srpskog arheološkog društva", do të thotë, "Buletini i Arkeologjisë së Serbisë", qashtu pikë për pikë e ka shkrujt. Dikush ka mujt me thanë, jo vetëm aty por në shumë vende dalin, ti ndaq, mos daq dalin, dalin sepse kultura mbi kulturë shkon. Ti nuk mundesh me thonë, "Kishat janë ato". Ti kishat i ke zatet, por ti ke ndërtu mbi një Kishë Paleokristiane, e kush ka qenë para juve? Madje edhe në asi... regjistrin e Leshanit shkrun mirë kur kanë ardh këtu, kënd e kanë zatet. Kanë zatet shqiptarët, vllahët edhe dubrovnikasët.

Erëmirë Krasniqi: Që kanë ardh me përpunu metal?

Luan Koçbashliu: Po dubrovnikasët, qoftë për minierat, qoftë zanatet, tregtia.

Erëmirë Krasniqi: Shumë interesant. E tjetër çka, në të '90-at çka ka ndodhë?

Luan Koçbashliu: Në të '90-tat që thash punumë edhe...

Erëmirë Krasniqi: Çka ndodhi me Muzetë? A ishin hala aktive?

Luan Koçbashliu: Me Muzetë pak ma rrallë, pak ma rrallë kanë fillu me punu. Fillojshin njerëzit me shkru edhe ato që nuk duhet me shkru në libër. Pastaj, unë u detyrova do me i hek mos me i lexu dikush po e kupton. Hajt po e zomë për shembull “Kosova Republikë”. Pse bre djal e ki shkru këto? Vijshin vizitorët kështu. E çka i kena pasë vizitorë pastaj shkollat, se shkollat janë angazhu, shkollat vijshin me u njoftu me trashëgiminë arkeologjike sepse për trashëgimitë tjera prej profesorave kanë mujt për trashëgiminë arkeologjike të Prizrenit. Vijshin kështu delegacionet pak ma rrallë viteve të ‘90-ta, a deri në atë moment kur fillun ato trazirat u rrallu. Unë po them letargjia ka fillu në arkeologji prej viteve të ‘80-ta, pas atyre demonstratave, ndërhyrjes, pushtetin e murren edhe krejt ato.

Erëmirë Krasniqi: A ka naj përvojë gjatë punës të juj që osht’ interesant me u trajtu që mos të kalojmë menjëherë te pjesa e luftës se qaty kemi mbrii kronologjikisht? A ka diçka që kishe dashtë me ju kthy a të ecim tutje? Po mendoj që është me randsi gjatë zhvillimit të juj profesional.

Luan Koçbashliu: Gjatë zhvillimit tim profesional, po në përgjithësi unë kam thanë. Por, përveç që kam punu në arkeologji unë kom punu edhe i krysha detyrat e tjera çka lidhen me mbrojtjen e monumenteve. Shkojsha me fotografu, për shembull objektet brenda, jashtë. Në rast se ka naj gjetje arkeologjike, unë u merrsha me ato, secili nga fusha e vet. Historiani e merrke historikun, etnologu për veshjet nëse ka ekzistiu do veshje, orientalisti naj libër. Atë punë do të thotë unë e plotësojsha pasi nuk kemi mujt përveç se do të thotë përcjellja e vizitorëve në Muze edhe atë punë e kemi bo. Kohë pas kohe shkojshim në gërmimet qato qoftë me karakter të shpëtimit, qoftë me karakter mbrojtës, qoftë me karakter të gërmimit sistematik, por ma pak ka qenë. Pas luftës veç ka fillu ajo, është etapa ndryshe, kemi qenë full puro të angazhum për çdo vjet.

Erëmirë Krasniqi: E qysh ka qenë lufta për juve?

Luan Koçbashliu: Drejtë me ju thonë si çdokush që e ka përjetu luftën edhe na e kena përjetu me strese e me ka krejt. Diçka e befasishme nuk osht’ në pyetje, njëfarë ideologji. Unë nuk kam mujt me marrë me mend që mundet me ndodh qashtu diçka. As në andërr drejt me ju thonë, as në andërr qaq kena qenë, qaq e kena pasë një jetë alegro me thonë a po kupton. Do të thotë, pa njëfarë... po vreheshin dallimet. Pak a shumë ka qenë, krejt ato varet prej njeriut qysh e ka eduku familja e tij e sjellja e tij. Kemi pasë njerëz të ngarkum e tepër të ngarkum, tepër të ngarkum edhe shifet që është i ngarkum, që na erdh periudha e jonë e s’di çka. Kështu që, mu më ka befasu drejtë me të thonë.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ke kur fillun bombardimet? A u largut prej shpijave? Çfarë përvoja keni pasë?

Luan Koçbashliu: Për familjen time po mendon?

Erëmirë Krasniqi: Po.

Luan Koçbashliu: Ma s'pari, në banesën e kam në Ortakoll, banesa si banesë edhe aty përzimje (buzëqesh). Veç fillun ato dallimet mes nacionaliteteve edhe brenda banesës aty. Çka me bo, tek me bo, djalë i ri u tutke, "Babë, çka me bo?" Thashë, "A po shkojmë te gjyshi e te gjyshja këtu?" Këtu kanë qenë vajzat, djali me ne. Për mu nuk ish me shoqen diqysh kishim mujt me dalë aty. E thirra baxhanakun, Norën e njeh ti [i drejtohet intervistuesës], është vajza motrës së grusë dhe thashë, "M'fal Baxh, a po na pranon?" Se na jemi edhe kusheri me familje Arap, kështu afër edhe baxhanakë jena bo. Bile baba menxi po pret me ardhë edhe ai ka qenë në penzion atëherë.

Shkum na atje, oborri i madh. Dilshim najherë me marrë bukë. Vajzat mbeten këtu {tregon me gisht} shumë keq ka qenë, këtu policia {bën me gisht prapa}, ushtria, çka s'ka qenë. Vëllaun e kam me banesë qaty te "K" ku osht'. Tash vajzave edhe djalin edhe vajzave kur, "Po shkojmë te axha", e aty ma kompakt ishin edhe ato sendet aty që ishin, prezrenasit ishin, "Vajzat e djali le të flejnë te na". Gruja thojke, "Jo bre dhondër", "Këtu sigurtë janë te na, na prej vegjëlisë njihemi me këta". Kështu ata rijshin aty. Një herë prej baxhanakut na erdhëm këtu, masandej u mbyllëm deri te ditët e çlirimit kur fillim këtu defiletë, ushtria jonë hini. Qashtu e kalum atë periudhën.

Erëmirë Krasniqi: Domethonë, serbët që kanë qenë gjithë me juve e kishin qasjen tjetër ndaj luftës a po?

Luan Koçbashliu: Po.

Erëmirë Krasniqi: Nuk ishin si ata që kanë ardh ma vonë?

Luan Koçbashliu: Jo, kqyre tash ato, ekziston një pjesë e atyne që shumë korrekt jonë konë, e të dhimen. Tash dorën në zemër, njerëz kanë qenë. Bile, ne që njihemi, ata pak a shumë si qytetarët, por ishin edhe ata që s'kanë besu. Për shembull, do që kanë mujt menjëherë me ato shajkaçat⁴, me ato veshjet me ka krejt. Unë kalojsha, vetëm keshja me veten thashë çka të vyn ajo veshje? A p'e sheh çka ndodhi? Erdhën çka bonën edhe shkun.

Erëmirë Krasniqi: Qysh filloi mandej jeta?

Luan Koçbashliu: Mandej jeta kadal dale mas luftës normalizohet, u kthym na nëpër punët, fillim me punu. Normalisht, i plotësum ato vendet me stafin e ri, por me profesionistët. Unë po ju them të drejtën me profesionistët.

Erëmirë Krasniqi: A kishte në atë kohë? Kish edhe krizë.

Luan Koçbashliu: Po në fillim krizë për pagesat, për krejt, nuk e kemi pasë pagesat kurgjo. Punojshim në fillim me na dhanë kta të UNMIK-ut ka njëqind, ka dyqind marka qashtu diçka si një rrogë deri sa u

⁴ Shajkaça (Šajkača) është kapelë tradicionale serbe.

konsolidu pakëz shteti, ministritë, deri sa janë formu pak a shumë. Pastaj, fillun punimet në arkeologji, heci mirë. Na e dhamë maksimumin tonë sa kena mujt edhe këta studentët historisë të cilët pastaj u tranferun në arkeologji, shkun kryenë masterin edhe doktorun në Francë. Tash janë ligjërues këtu. Unë besoj që arkeologjia kosovare ka ardhmëri, me këta ka ardhmëri, e kapën edhe katedrën për arkeologji.

[prerje në motrazhë]

Erëmirë Krasniqi: Ke një kuadër i mirë?

Luan Koçbashliu: Po mirë, janë entuziastë, janë punëtorë, kanë dëshirë me punu. Normalisht nëse kanë nevojë për ne t'vjetrit jena ktu. Gjithmonë e kemi ofru, gjithmonë e kemi marrë, ata kanë msu me ne, hapat e parë e parë i kanë bo me ne. Dashta me u kthy për Shqipni kur m'boni pyetje, "A ka qenë kush prej Kosovës?" Unë me sa e di ka qenë Exhlale Dobruna edhe Edi [Shukriu] ka qenë, m'duket në Apoloni, e këta tjerët pas luftës kanë qenë ky Pleurati, Arben Hajdari, Arben Arifi edhe s'di kush tjetër, Miloti.

Erëmirë Krasniqi: Në çfarë projekti?

Luan Koçbashliu: Në projekte me hulumtime me ata si studentë kanë shku.

Erëmirë Krasniqi: Në cilën zonë?

Luan Koçbashliu: Në Butrint edhe në Apoloni ma së shumti, e këta tash pas luftës po shkojnë edhe në vende tjera, këta studentët që janë të regjistruar tash.

Erëmirë Krasniqi: Shumë mirë.

Luan Koçbashliu: Edhe çka kena arritë na bashkë, kemi tre harta arkeologjike të Kosovës. I pari është do të thotë Rrafshi i Dukagjinit, Peja, në të dytën e kemi vazhdim Prizrenin, e dyta ka qenë Fushë Kosova, komuna e Drenicës edhe pastaj e patëm knej Elez Hanin, Anamoravës edhe Shtërpçën e knej Ferizajin. Të tre botimet i kemi. Do të thotë, kam marrë pjesë edhe unë në hartimin aty që nga fillimi edhe në projektet edhe në Ulpianë kam qenë katër vjet.

Erëmirë Krasniqi: A janë këto, se nuk e kam të qartë se nuk kom studiu arkeologji veç po du me ditë. A janë këto gjithmonë projekte të vazhdushme, nuk mbyllet kurrë një site.

Luan Koçbashliu: Po kur mbarohet mbyllet, varet krejt prej hecurisë edhe mjeteve se arkeologjia është shumë e shtrejt, por ma i shtrejt është restaurimi dhe konzervimi. Ajo osht', por ajo osht' edhe ma e dhimshme edhe kush e ka guximin me hi bravo i koft sepse duhet me respektu. Tash teknologjia

ka përparu, material për konzervim ke sa t'dush, jo ti me marr me shku anej, me marr tu e pasë gurët këtu të Kalajës. Ktu Kalanë qysh e kanë ndërtu? E kanë ndërtu prej lumit Bistricës e kanë marrë. Ani që po them Bistrica, është toponimi. Tash Lumbardhi është. A ka logjikë Lumbardhi? Përkthimi çka thonë, "Uji i bardhë". Uji i kthillt osht' Bistrica, bistro në sllavishtë osht' i kthjellët. Kqyre në Shqipëri nuk e kanë ndryshu toponimet. Nejse ajo osht' normal, ajo ndrrohet toponimet, odonimet. E dini çka osht' odonimet?

Erëmirë Krasniqi: Po emra të bazum në vend. Për toponim po.

Luan Koçbashliu: Toponim, a odonim?

Erëmirë Krasniqi: Odonim jo.

Luan Koçbashliu: Odonimi osht' rruga, por rrugica. Ajo osht' odonim e rrjedh nga greqishtja, odo osht' rrugica. *[Prerje në montazh]* Ishte puna për, unë po them e kam përjetu Prizrenin e vjetër. Kam përjetu krejt kalldërmat çka janë konë, krejt rrugët, rrugicat.

Erëmirë Krasniqi: Keni pasë shumë në të gjitha lagjet. A dini shumë për krejt qato lagje? A ju ka ra me hulumtu.

Luan Koçbashliu: Pak a shumë e di. Për shembull, e di gjatë, se i kam përcjell punimet hartimore qaty. Për shembull, nëse është në afërsi të një objektit. Kështu kam evidentu disa objekte të mahershme si për shembull ku osht' Kuvendi i Komunës së Prizrenit, aty afër edhe jam interesu edhe kam gjetë shumë fragmente të mozaikut të Manastirit të Kryeengjuve, ka qenë kryevepër e ndërtume në shekullin e XIV-të, por... Keni ni për Ravenën, Manastirin, një kishë katolike ma e njohur me asi, me mozaikun, me dyshtemenë mozaikun. Dushani⁵ kur ka ndërtu, ai e ka ndërtu se e ka pasë idollin Perandorin, asi perëndimin, artin e perëndimit e ka përvetsu e qashtu e ka bo edhe t'njejtën. Do të thotë, e ka emitu e ka bo sarkofagin e vet. Krejt i ka bo tu i imitu ato mbretërit e perëndimit.

Erëmirë Krasniqi: A keni gjetë fragmente?

Luan Koçbashliu: Fragmente edhe aty edhe nëpër qytete, nëpër mure. Tu hecë *krap* {onomatope} ktu. Te kisha e kam vrejt {tregon me gisht}, edhe te kisha. Ju po thoni që asi, Xhamia e Sinan Pashës osht' ndërtu me materiale, osht' e vërtetë. Unë i kam gati njëqind vizatime që i kanë bo në Manastirin e {kollitet}, në Muzeun e Kurshumli Hanit në Shkup, brenda kanë vizatu, e kam nalt fletoren, viteve të '90-ta kur kena shku, me material me krejt osht'. Materiale atje ndodhet, se gërmimet e para atje janë bo në 1926-27 nga profesor Grujiq që e ka bo. Ka qenë atëherë *Južna Serbia*, Serbia jugore e kryeqyteti i Serbisë Jugore ka qenë Shkupi edhe aty në atë Muze janë vendosë. Si kryeqytet janë vendosë krejt

⁵ Stefan Urosh IV, apo Dushan Nemanjiq, ishte mbreti i parafundit serb nga dinastia Nemanjiq. Ai mbajti titullin e mbretit nga 1331 deri në vitin 1346.

materialët, mbi 1800, gati dymijë eksponate janë në Kurshumli Han, qoftë gurë të plastikës, qoftë materiale kështu. Edhe na kemi shku me qatë drejtoreshën edhe ajo e arkeologjisë, në '73-shin, '73-shin, jo '93-shin, '94-shin. Ajo ka qenë drejtoresha pastaj, si serbe.

Erëmirë Krasniqi: Ju e keni kqyr çka është mbledhë?

Luan Koçbashliu: Po, çka u mbledhë edhe unë kam ndejt, e kam vizatu, e kam vizatu komplet. Tash po du me botu ato, por po du me fol me Enverin e Institutit kur t'bohet ajo Buletini i Institutit me botu edhe qato. Janë do që janë të botume, janë do edhe që s'janë të botume.

Erëmirë Krasniqi: Kur kanë ndodh këto ndryshimet, se unë kur ju pyta për urbanizim mendova ma shumë këtë socialist edhe po menoj kur kanë ndodh qato shkatërrimet.

Luan Koçbashliu: Shkatërrimet, po, po.

Erëmirë Krasniqi: Domethonë, ju keni qenë i ri.

Luan Koçbashliu: I ri kam qenë. M'kujtohet një mbledhje në Therandë e '76-tës, para, e '76-tës para se me shku në ushtri. Në Therandë i ndjeri Bashkim Fehmiu, arkitekti, një ligjeratë e ka bo për Prizrenin edhe për urbanizmin e Prizrenit. Ai ka qenë urbanisti i njohun në atë kohë. Megjithatë, unë kam pasë djalin e axhës urbanist shumë i i njohur, qysh me thanë, vendin e parë e ka zanë në Paris një projekt edhe qerdhja e fëmijëve ka hi në enciklopedi si ma e, qysh me thanë ma adekuate për fëmijët e moshës, fantazi diçka edhe hala punon, hala punon projekti i tij. Tash mos po dalim prej temës, folën çka me bo me Prizrenin, tek me bo. Socializmi ka fillu pak ma vonë, Narodna Republika ka qenë ma përpara.

Dy arkitektët, njëfar Kojiq e Zoran Petroviqi të Beogradit kanë bo një analizë të Prizrenit të tërësishëm, në çdo send edhe aq kanë qenë qysh me thonë, i kënaqun që kanë punu këtu në Prizren se kanë pasë origjinal pa e prek në një qytet edhe për qato e kanë emëru, "Prizreni qytet muze" edhe jo muze, por përmendore, kurgjo e paprekne edhe kanë fillu me projektet. Ata kanë qenë do të thotë arkeologët jo të ngarkuar, arkitektët korrekt, që s'kanë dashtë me prish kurgjo, analizat, rrugat, rrugicat krejt komplet.

Por, Prizreni i pari qysh ka fillu me u prish gjatë, pas Luftës së Parë Botërore kur sundoi Mbretëria, apet Kraljevina, Serbia. Ishte një kapetan Korunoviqi, kapiten i ushtrinë, por ndërtimtar. Ai ka ndërtu prej Bazhdaranës deri te kjo ura {tregon me gisht} me qatë rrugën. Qatëherë u ndërtu edhe *Dom JNA* [srb.: Shtëpia e Armatës] edhe qiky sheshi qitu, sheshi që osht' qitu edhe do rrugicat ai i ka bo. Do të thotë edhe kur kanë ardh për shembull, kur kanë fillu migrimet nga fshati në Prizren, ka fillu ma së shumti kanë migru serbët.

[prerje në montazhë]

Po, migrimi prej fshatnave edhe ndryshimi po thotë në arkitekturë ka fillu viteve të '20-ta kur u ktheheshin zjetarët, tregtarët e shkojshin në shtetet e huaja në perëndim me punu, kanë përfitu edhe qysh kanë përfitu. Do të thotë, kanë punu, kanë përfitu pare edhe tash nuk don me jetu në shtëpi të vjetër. Atëherë ka qenë ligji i mbrojtjes por nuk ka qenë në fuqi pas Luftës së Dytë Botërore. Atëherë kanë fillu në '45 veç monumentet e para, ndër ato janë edhe Kalaja çka osht' fut në mbrojtjen, Kisha e Shën Premtes, Xhamia e Sinan Pashës në ato vite menjëherë pas luftës. Do të thotë, ajo nuk osht' korrekte, nuk e kanë dallu kjo osht' myslimane, kjo osht' katolike, kjo osht' ortodokse.

Ajo ka qenë ideologjia ashtu edhe njerëzit e kanë respektu. Për qato thash edhe tu i lexu librat aty, i kam këtu, shumë konstruktive i kanë bo edhe kadal dale s'ka fillu. Ata që erdhën, cincarët sidomos, tregtarët, pasanikët a e keni vrejt këtu kanë fut në Shadërvan edhe do shtëpitë që i kanë vitin e ndërtimit. Ajo post-moderne, ajo dominimi i eklektikës në arkitekturë. Eklektika e dini osht' vjedhja ose imitimi ose me thanë pseudo, pak e përngjanë.

E qato janë edhe Bashkimi atëherë filloj me tregu boll duhet me rujt këto, duhet me thy këto. Por, diçka mu m'çuditë tash për shembull nuk duhet qaq ashpër me shku. Paramendoni tash mbi urës, Ura e KFOR-it thojshin, a kjo ura është Ura e Arastës {tregon me dorë} (buzëqesh), Ura e Arastës e qaty ka qenë "Kapali Çarshia", i kemi fotot, "Çarshia e Mbyllur", se Arasta në përkthim osht' tregu që shet vetëm një lloj materiali që shet.

Erëmirë Krasniqi: E specializume për diçka.

Luan Koçbashliu: E specializume qoftë për shembull, për qato tregu i djathit ka qenë aty ku osht' tash, ato zbulime që i kemi gjetë na, ajo rastësisht u gjetë aty. Kanë dashtë çeshmen, një fontanë me bo e ja nisën aty. Tash qajo fontana e kemi formën, po thojnë, "Baptisteri ka dalë", baptisteri herët osht' me fol. As nuk e kanë vrejt, unë e gjeta vulën në tullë edhe nuk... vulën e kam unë, jo vulën por tullën me vulë. E kam fotografu edhe në një mbledhje vullnetarisht me shku edhe me tregu, "Qe e keni, qikjo ju tregon periodizimin ku osht'", "Jo kjo ka qenë xhamia, jo ka qenë kështu. Ky prifti po thotë baptisteri ka dalë, kam lexu", "Ku ke lexu për këto? S'ka shansë me lexu". Don Shani, ai faktikisht. Po ai e ka bo katastrof kishën. Pastaj erdhën prej Institutit kanë punu vjet, me Institutin e Zarës në bashkëpunim. M'duket që kanë përparu diçka edhe kanë marrë mostrat për me bo hulumtimet antropologjike. Ajo osht' mirë se antropologjia me arkeologjinë ta tregon ty origjinalitetin, s'ke çka me lëvizë. Merr ADN-në edhe u kry puna.

Erëmirë Krasniqi: Qysh i komentojke ndryshimet Bashkimi [Fehmiu] në Prizren?

Luan Koçbashliu: Jo me qenë qaq asi, për shembull me ndërtu Kullën e Ajfelit mbi urë. Po qitash çka janë tu bo osht' katastrofë me këto ndërtesa. Unë s'e di çka ka me metë prej Prizrenit nëse kanë mbetë

pesë, gjashtë shtëpi që ja vlen me prezentu. Por, jo sundimi i ligjit, ligji nuk sundon edhe atë ligjin nuk e kanë përpilu deri tash. Sa vijnë në trajnime e vijnë prej s'jashtit, hin këtu del këtu {prek veshët}. Gjithmonë koka thotë, "Bojmë si të dojmë na", s'bon ashtu.

Erëmirë Krasniqi: A ju kujtohet kur e kanë rrxu atë Xhaminë?

Luan Koçbashliu: Cilën Xhami?

Erëmirë Krasniqi: Që e kanë lonë veç minarën. Nuk ja di emrin, por aty ku u ndërtu "Theranda", n'qatë zonë në qendër.

Luan Koçbashliu: Xhamia, a po, po unë kam qenë i vogël. Arasta, Xhamia Arasta e këtu e kanë gjetë një mozaik, mozaiku është gjetur aty.

Erëmirë Krasniqi: Domethonë, me çdo rindërtim ka pasë edhe zbulime.

Luan Koçbashliu: Po, qysh jo. Gjithmonë zbulime Prizrenin e ka. Prizreni ka qenë i dendun {kryqëzon gishtat}, urbanizmi i Prizrenit sa... Unë do të thotë unë drejtohem edhe e marrë prej literaturës çka shkrun, kanë shkru ata të, unë nuk jam ekspert për arkitekturë ose për diçka. Ato na i zbulojmë edhe po i lidhim menjëherë. Xhamia e parë është ndërtu qaty ka stacioni i autobusave në Namazgjah.

Erëmirë Krasniqi: E tash a po shërbejnë si pikë-nisje ndërtimet sot që po ndodhin? Nëse ka gërmime për me shtru teme, po ves a po ndodh...?

Luan Koçbashliu: Po rrxon teme nuk tregon, n'rast se tregon naj kojshi, "Shkoni bre!" Kur shkojmë na veç e ka mbulu edhe maroi. Qashtu shumë sende janë hup në Prizren. Ato çka kam regjistru unë një ditë kam me qit unë. I kam të regjistru, ka edhe në Institutin Arkeologjik, se na e kemi pasë detyrë raportin ku ki qenë në terren çka ki bo, tek ki bo, përshkrimin e krejt. Sipas kësaj mundet me zhvillu. Ka, ka elementet në "Therandë", ka elementet knej {bën më gisht prapa} ku osht' Xhamia e Sinan Pashës, jo Sinan Pashës por Bajrakli Xhamisë. Kanë element edhe aty.

Shumica nuk e dijnë edhe një rrethmuri e ka Kalaja. Ata s'po doken e unë prej ktuhit pe vrej, se e kam vrejt këtu pastaj i kam thanë një kolegut, "Hajde tash e fotografojmë, e vizatojmë edhe raportin ia çojmë Institutit". Deri vonë s'kam ditë, dy reshte muri mbrojtës. Aty ku kanë mujt, ku ka qenë do të thotë për mbrojtje nga sulmi, se ato ku janë pjerrët, ku janë pjerrtësi ku nuk mundet me shkel njeriu ose me sundu prej atjehit, ka muret.

[prerje në motazhë]

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenë kur jeni pensionu? A jeni mërzitë?

Luan Koçbashliu: Jo, s'jam mërzitë se veç kam qenë i angazhum në hulumtimet kështu vazhdimisht deri vitin e kalum edhe sivjet pak pandemia edhe pak mosmarrja, pjesëmarrja ime tash unë thashë deri sa muj, deri sa jam n'kamë kështu muj me dhonë kontributin tem n'rast se kanë nevojë unë vet me shku, në rast se kanë nevojë. Por, falë respektojnë, po m'thirr in ata kush dojnë, po jep mundësi qato çka di unë. Ata kanë msu tash, dijnë me gërmu, dijnë krejt, por pak a shumë një, qysh me thonë, një mendim me marrë, një raport me marrë nuk osht' i keq, nuk osht' i keq.

Nga profesori jem ku kam bo hapat e para, Jovan Kovaqeviqi, ai ka kry studimet në Sorbon në atë kohë, se krejt ata jashtë e kanë kry edhe tha, nuk ka mujt me m'thirrë Luan, kur folke bojke qeshtu, {prek fytin} "H, H, Huan", thashë, "A profesor, ma bone ti mu spanjoll, meksikan" (qesh), tu e kesh... Edhe më tregoi, "Ti nuk do të jesh arkeolog në rast se përvetëson një element, një send prej terrenit. Mos thuj për vete që je arkeolog. Si mjekët kur e japin atë betimin e mjekëve, qashtu qajo osht' betimi i arkeologëve që nuk do të marrësh kurgjo".

Megjithatë, unë e kam koleksionin tem. Për shembull, njoni ktu i Prizrenit paska ble diku do unazat të periudhës romake atje në Vojvodinë, osht' një vendbaim i periudhës romake. S'di qysh e ka tek, grujën e ka prej atjehit edhe "Luan, a po don me marr?" "Po, ta blej", se po mendoj që e ka marrë diku prej lokalitetit. E mora valla për kuriozitet qaty e mbaj, por nuk osht', nuk i përket ktuhit (qesh). Se arkeologjia i ka shumë sende kështu, por osht' një profesion shumë, shumë qysh me thonë edhe alegro, me knaqësi me punu. Me të vërtetë nuk u bo pishman.

Tash m'kujtohet miku im, jeton në Zagreb tash, Mensuri, Petriti e njef me siguri [i drejtohet intervistuesës], Mensur Gjergjizi vllau i grujës edhe këtu ka punu në KSIKOS, pastaj u transferu atje në Zagreb. Atje e ka çelë firmën e vet edhe ka punu edhe m'thojke, "Kqyre bre Luan, une me pasë edhe një herë me lindë kisha zgjedh arkeologjinë. Po ti po knaqesh" (buzëqesh) edhe me të vërtetë osht' knaqësia. Për qato ia kam imponu edhe vajzës teme. "Çka me studiu?" "Po merre ti vajzë hajt etnologjia, ndoshta burri nuk t'lejon me dalë nëpër terrene, se arkeologjia kërkon ma shumë. Merre etnologjinë" edhe nuk u bo pishman.

Erëmirë Krasniqi: Shumë mirë. Shumë faleminderit!

Luan Koçbashliu: S'ka përse, ndoshta ju kam lodhë.